Asambleja
01.Nr.VIII
Deçan,dt.31.10.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e VIII-të, të rregullt të Kuvendit, me dt.31.10.2025.
Në mbledhje ishin prezent:22 anëtarë të asamblesë, disa drejtor të drejtorive komunale(3), Shefeje e Kabinetit të Kryetarit, Manjolla Shala, Shefja e Drejtorisë për Shërbime Publike, Gentiana Mazrekaj, OSBE.
Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, z. Hajdar Sutaj.

Për mbledhje ishte propozuar ky rend pune:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i:
   - Transkriptit nga mbledhja e dt.30.05.2025,
   - Transkriptit nga mbledhja e dt.27.06.2025,
   - Transkriptit nga mbledhja e dt.31.07.2025,
   - Transkriptit nga mbledhja e dt.29.09.2025.
2. Shqyrtimi i Raportit të performancës,
3. Shqyrtimi i Raportit të KKSB-së,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi mbledhjen e VIII-të të rregullt të Kuvendit duke i përshëndetë pjesëmarrësit, verifikoj pjesëmarrjen e anëtarëve dhe konstatoj se në mbledhje marrin pjesë 22 anëtarë të kuvendit.
Kryesuesi në vazhdim e prezantoj rendin e punës të propozuar me ftesë pastaj e hapi debatin rreth tij.
Vatan Istrefaj- fillimisht ka kërkuar arsyen pse Kryetari nuk eshte këtu me ne, e dyta sa i përket KPF-së, sepse siç e dimë jemi në fund të mandatit dhe siç po shihet nuk kane ardhë rekomandimet e KPF-së, gjithashtu kemi kërkuar një raport sa kërkesa financiare kanë kaluar në KPF pasi që jemi në fund të mandatit, a janë ekzekutu ato dhe a kan shkuar ne rrugën e duhur, poashtu kryesues disa herë në KPF, drejtorët qe kanë pru tema aty, nuk kanë ardhur per ti mbrojtur dhe shpresoj që kjo mos të na percjellë në mandatin e ardhshëm.
Kryesuesi- po, realisht këto janë punë të sekretarisë dhe shpresoj që tani pas miratimit të rregullores për sistematizimi te vendeve te punës sekretaria e kuvendit ta kete akipen e vet dhe te siguroj me kohe te gjitha dokumentacionet e nevojshme, ndërsa kryetari mungon ne mbeldhje sepse eshte jashtë vendit kurse sa i përket antarve te ekszekutivit ish fashte te jene prezent por po shofim se nuk janë këtu sepse materialin dhe ftesën e kuvendt e kane dhe ne nuk mund ta detyrojmë kerkend qe te vjen ne mbledhje, poashtu me lejoni qe ta falënderoj kolegen tone Yllarta Thaqi e cila ka kontribuar qe sot ti kemi këto fjongot qe tregojnë se janë solidarizim ne kuadër te senzibilizimit ne muajin roze te luftës kundër kancerit te gjirit edhe pse eshte dita e fubdit ne kuadër te këtij muaji, urojme dhe dëshirojmë qe te kemi raste minimale dhe hiq raste te tilla.
Meqenëse nuk kishte të interesuar tjerë për ta marrë fjalën, kryesuesi e qiti në votim rendin e punës dhe konstatoje i njëjti miratohet njëzëri nga 22 anëtarë prezent sa janë në mbledhje.

I. Shqyrtimi dhe miratimi i:

- Transkriptit nga mbledhja e dt.30.05.2025,
- Transkriptit nga mbledhja e dt.27.06.2025,
- Transkriptit nga mbledhja e dt.31.07.2025,
- Transkriptit nga mbledhja e dt.29.09.2025.

Kryesuesi- i prezentoj të katër transkriptet dhe fillimisht e hapi diskutimin per transkriptin e mbledhjes së dt.30 Maj dhe per secilin transkript do ta shqyrtojmë dhe miratojmë veçantë, mirëpo anëtarët e kuvendit ishin të mendimit që të 4 transkriptet të shkojnë si paketë, të shqyrtohen dhe miratohen për një herë.
Miftar Ahmetxhekaj- kërkon që të bëhet korrigjim te traskripti i datës 31 korrik te faqja nr.7, ku unë ka thene ai kam diskuatuar rreth buxhetit kurse diskutimi im eshte bartur te emri i kolegut tim Vatan Istrefaj.
Kryesuesi- me korrigjimin te transkripti i datës 31 korrik 2025 te faqja 7 ku duhet te jete Miftar Ahmetxhekaj ne vend te Vatan Istrefaj, e qiti ne votim katër traskritet nga mbledhjet e kaluara, Kryesuesi ka kontsatuar se antaret e kuvendit njëzëri i kanë miratuar katër transkriptet nga mbledhja e dt.30.05.2025, dt.27.06.2025, dt.31.07.2025 dhe transkriptin e dt.29.09.2025.

II. Shqyrtimi i Raportit të performancës.

Kryesuesi- e ka prezentu piken e dyte te rendit te ditës Shqyrtimi i Raportit të performancës dhe fillimisht e ka falënderuar Shefen e kabinetit te Kryetarit, Manjolla Shala, per punën e jashtezekonshme qe ka bere ajo bashke me ekipin e vet duke e renditur komunën e Deçanit ne vendin e gjashtë nga vendi i 28 qe kemi qene vitin e kaluar dhe fillimisht fjala ne foltore per zonjën Manjolla Shala.
Manjolla Shala- ka thene se ka punuar me shum përkushtim ne kete drejtim dhe rezultatt nuk kane munguar, por ajo ka ceke fushat ku kemi pasur ngecje, e kemi nivelin e transmetimit te zyrës kombetare te auditimit, nga viti i kaluar ne kemi pasur përmirësime, kemi arritur qe te mbledhim 64 pike, mirëpo pas vlersimit ata na kane vlersuar me 47 pike, sepse aty kërkohet te vendoset rekomandimet e mbyllura qe kane tri dhe aty na u ka zbrite përqindja, e kemi pasur raportimin e planit te integrotetit ne kuvendin komunal ne muajin dhjetor, gje qe nuk eshte bere ky raportim, kemi pasur nivelin e vlersimit te planit komunal per reagim emergjent kurse ne nuk e kemi nje plan te tille por shpresoj ta kemi se shpejti, kemi territorin e komunës se Deçanit te rregulluar sipas planeve rregullative komunale, këtu i kemi 30% te pikëve, kjo për shkak se na mungojnë hartat zonale, por besoj se kete vit përfundohen hartat zonale dhe besoj se do ti marrim 100 pike. Kemi tek barazia e fushave, te barazia gjinore e kemi gjendjen pak me keq per shkak te gjendjes siq e dimë qe kemi këtu i kemi gratë me pozita udheheqse ku kemi arritur ti marrim 27 pike, sepse nuk kemi gra drejtore aq sa kekohet, te Keshillat e fshatrave nuk kemi asnjë grua dhe këtu kemi zero pike, por kjo nuk varet nga ne, kemi perfqasimin gjinor tek emërtimi i rrugëve dhe këtu duhet te kemi ma shum por i kemi vetëm 8, tek regjistrimi i pasurisë ne emër te dy gjinive këtu i kemi 7 pike sepse këtu duhet te vendosim pronat qe janë në emër te dy bashkeshorteve, ku per fat te keq nuk kemi shum gra qe janë pjese e pronësisë, edhe e kemi nivelin e pajtueshmërisë me ekipet e mjeksisë familjare te shëndetit oral këtu i kemi 50 pike, ktu kemi pasur 80 pike por këtu MAPL ka vendose qe te merret per baze numri i popullsisë

nga viti 2011 kurse ne kemi shkuar me parametrat sipas regjistrimit te popullsisë nga viti 2024.
Kryesuesi e hapi debatin rreth kësaj teme dhe fillimisht fjalën ia dha grupit tëAAK-së.
Arjan Dobraj ne emer te grupit te AAK-së- meqenëse ne baze te raportit paskemi pasur rritje ose përmirësim ne disa aspekte atëherë na mbetet me tu falënderu Manjolla per punën që ke bere dhe me te uru suksese ne vazhdimsi, faleminderit.
Blinera Lokaj- ne emër te LDK-së- raporti i performaces na ofron nje vlerësim te rendsishem te punës se komunave ne ofrimin e shërbimeve per qytetaret si dhe ne realizimin e punëve ne harmoni me legjislacionin ne fuqi, duke ju referuar te dhënave te këtij raporti shofim se përmirësimet janë evidentuar ne disa fusha, tek përgjegjshmëria komunale eshte treguar per afatet ligjore, me gjith ate sfide mbetet pjesëmarrja e ulet e qytetareve ne konsultime publike poashtu sfide eshte edhe procesimi i nivelit te pagesave ne afate ligjore prej 30 ditesh gjithashtu komuna duhet ti përmirësoj edhe nivelin e adresimit te rekomandimeve te dhëna nga zyra kombetare e auditimit e cila aktualisht mbetet e ulet, poashtu edhe raportimi i planit vjetor te zbatimit te planit te integritetit ne kuvendin komunal ku une kam kërkuar qe ky plan te perfshihet ne planin e punës per vitin 2025, por qe ende nuk ka ardhur ne shqyrtim, te dhënat e këtij raporti komuna e Deçanit duhet ti merr si refernce per te përmirësuar cilsine e shërbimeve per qytetaret poshtu te rriten kapacitetet e nevojshme per përfitimin e grantit nga komuna ku do te realizohen projkete te tyre.
Orges Tafilaj- ne emër te VV-se- përgëzime Manjollla per punën qe ke bere dhe renditjen per grandin e performaces, mirëpo nje pjese këtu nuk eshte ne dorën tone siç eshte te tatimi ne prone, meqenëse eshte pak problem sepse nje pjese e madhe e pronave eshte ne emer te gjyshërve dhe stërgjyshërve dhe eshte kogja problem me zgjedhe, megjithatë meqenëse tash edhe pjesa e kontratës kolektive po përfundon ajo qe duhet ti kushtohet kujdes eshte pjesa e pagesave ne afatin 30 ditor ne menyre qe te mos kemi përmbarime dhe te kemi nje raport te auditorit me te mire ne menyre qe te fitojmë mjete nga granti i performaces dhe ato mjetet te shkojnë ne te mire te qytetarve.
Mon Selmonaj nga PDK- nje pyetje dashta me ba por se pari e përgëzoj grupin punues per ngritjen ne renditjen e transparencës, por ne dy tri raste nuk po perputhen piket e komisionit me piket e kutis se ankesave si psh. Te pjesëmarrjet e qytetarve ne konsultimet publike piket e raportimit janë 57.13 ndersa piket vlersimit te ankesave eshte 39.65, dhe ne renditjen 15.2.1 niveli i pajtueshmeris me ekipet e mjeksis familjare 90.74 ndersa vlersimi behet me 53.36 dhe kërkoj sqarim se a kan vërtetu këtu qe ka te dhëna te pasakta këtu, apo qka eshte ne pyetje këtu te këto ndryshimet e referencave.
Manjolla Shala- ashtu qysh e theksova po e sqaroj edhe nje here ne fillim te raportimit kur është hapur raportimi i te dhënave per performancen komunale na eshte thene qe duhet te raportojmë me regjistrimin e popullsitë te vitit 2024 qe i bie qe i kemi 27.000 banor dhe pasi qe ka perfundu raportimi dhe ne e kemi mbyll procesin Ministria na ka njoftu se përsëri do te behet vlersimi me te dhënat e regjistrimit te popullsisë se vitit 2011 dhe pasi qe kemi pasur nje ndryshim shum te madh ne numrin e popullsisë nga dy regjistrimet kjo ka ndikuar qe te na ulen piket, per shkak te numrit te banorve, sepse shum prej treguesve jan ne përpjesëtim me numrin e banorve, ne kete rast edhe pjesëmarrja e qyterave ne

konsultimet bulike, edhe te grupet e ekipet familjare sepse sa i përket numrit te banorve te vitit 2024 ne i kemi te gjitha te dhënat dhe plotësojmë kushtet dhe i kemi te gjitha ekipet familjare qe kërkohen por edhe në shum tregues tjerë kjo ka ndikuar që të na ulen pikë.
Yllarta Thaqi-pergezime per rikthimin e pozitës tek performanca, sepse duhet bere pune voluminoze per te mbërri deri tek ky nivel, duke ditur qe ne vitin 2018 kemi qene te renditur ne renditje te paret dhe renja ne nivel aq te ulet ka qene dëshpëruese, uroj qe vitin tjetër te kemi ngritje pak me te larte duke marre parasyshe se i kemi rekomandimet ku mund te përmirësohen, sisdomos te barazia gjinore, shpresoj qe te miratohet plani i kryetarit ku ka premtu ma shum gra ne pozita udhehese dhe ky indikator plotësohet, njekohsshiht edhe te shërbimet publike edhe te vërejtjet tjera qe mos te penalizohemi vitin tjetër.
Vatan Istrefaj-per te mos i përsëritur ato qe i thane kolegët po shtroj pyetjen, a keni bere ndonjë analize cilat nga këto te dhënat, cilat nga këto referenca duhet te plotësohet qe te rritet perqidja e tyre, psh e kemi te gratë ne pozita udhëheqëse ne shëndetsi, kulturë, sport etj. a mund ta merrni përsipër qe këto ne vitin e ardhshëm do te rriten per shkak se nëse jemi te vlersuar ma larte do te jemi edhe përfitues te grantit per performace komunale qe do te ndikonte shum mire.
Manjolla Shala- te gratë udhëheqëse, ashtu siq e ceka, janë tek drejtoret e shkollave, janë tek QKF, apo tek drejtoret e ndonjë qendre rinore ku nuk besoj shum se do te përmirësohet, sepse psh per te qene drejtor i nje shkolle duhet ti plotsoj disa kushte tjera dhe nuk varet nga ne se kush duhet te vendoset si drejtor aty burrë apo grua, kështu qe te barazia gjinore nuk varet shum nga ne përmirësimi, sepse duhet te vjen ne shprehje meritokracia, kurse te disa pike tjera besoj se do te dalim shum me mire, psh te raportimi i planit te integritetit ku kete vit e kemi ne plan pune dhe do te raportojmë, poashtu edhe shum tregues kan te bëjnë me numrin e banorve dhe kete vit do te dalim shum ma mire .
Albesa Cacaj-e nderuara Manjolle theksoj se per disa qeshtje nuk varet nga ne dhe une du me theksu qeshtjet te cilat varen direkt nga zyra e kryetarit nga ekzekutivi, e para qe du mi theksu eshte pjesëmarrja e qytetarve per konsultime publike, te gjith jemi dëshmitar se kur mbahen konsultimet pulike shum pak ka pjesëmarrje te qytetarve, e kjo duhet me ju ba me mëndu per papërgjegjshmërinë qe tregoni karshi qytetarve qe don me than se konsultimet publike mbahen me ekzekutivin dhe jam deshmitare e asaj qe qytetaret thojne se e kam humb besimin, sepse tuj adresu qeshtjet vit pas viti dhe asnjëherë nuk merren parasysh, pastaj ajo qe e kini ne dore per mi bo edhe mi permirësu eshte niveli i zbatimit te rekomandimeve te auditorit te jashtëm qe e kam ngrite disa here si qeshtje ku jan periudhat periodike, afatet ligjore ku duhet Kryetari dhe Ekzekutivi me ardhe me raportu sa i përket adresimit te veprimeve qe duhet me i marre komuna per me dale ne vitin e ardhshëm me mire. Çështje tjetër qe du me theksu janë rrugët lokale te mirëmbajtura veres dhe dimrit, ne qe jetojmë këtu e qe përballemi me kete sfide e kuptojmë se kjo nuk kryhet ashtu siq parashihet edhe qysh duhet, pastaj kemi mungese te rrugëve me shteg te biqikletave por çka eshte me e rëndësishmja eshte realizimi i planit per barazi gjinore ku thot osht me 100 pike na si kuvend e kemi aprovu ni plan te veprimit per barazi gjinore ne te cilat shihen aktivitetet dhe objektivat qe duhet mu marre ai dhe te paktën kryetari nje here ne vit duhet me raportu. Kryetari nuk ka ardhe me raportu ka ardhe zyrtarja qe e mbanë ate post dhe

asnjë aktivitet qe eshte parapa ne ate plan nuk eshte realizu, per kete kërkoj sqarim si jemi rendite me 100 pike ketu.

Manjolla Shala- sa i përket pjesëmarrjes se konsultimeve publike ma se pari antaret e kuvendit nuk marrin pjese te gjithë, te barazia gjinore plani duhet te raportohet sipas nje plani vjetor te zyrtarja per barazi gjinore dhe te raportohet ne kuvend dhe vlersimi eshte bere nga ministria bazuar ne te dhënat e publikuara dhe nuk besoj se ka diqka qe nuk eshte vlersuar drejt.

Kryesuesi- i falënderon te gjithë ata qe kane kontribuar rreth kësaj teme dhe e mbylle debatin ne kuvend sa i përket kësaj pike duke dëshiruar ne suksese te me tutjeshme.

III. Shqyrtimi i Raportit të KKSB-së.

Kryesuesi- e ka prezentu kete pike dhe per sqarime e ka ftuar, Gentiana Iberhysaj-Mazrrekaj.

Gentiana Mazrrekaj- fillimisht kerkon falje per vonese te materialit dhe kjo ka ndodhe per shkak se mbledhja eshte mbajtur te merkuren me dt.29 dhe arsyeja ka qene koha e kufizuar per pergaditjen e raportit te performances komunale dhe per kete procesverbalin e kini marre bashke me rendin e dites I kini marre dhe I kini ne dispozicion.

Arjan Dobraj – ne mer te AAK-se, thot faleminderit kryesues per fjalen por nuk pata diqka me shtu, por keto dite ne fshatin tim e kam verejte nje reklame me dy polic dhe mu duk nje akt shum I mire nga ana e policisë se Kosoves qe besoj se është bere ne bashkepunim edhe me kryetarin, por une ketu e pata hallin se keta dy polic a ka mundesi me I kontaktu, apo ka qene e udhes ma shpesh me ba kontrolla rutinore edhe me I pyet qytetaret anonim per problemet qe mund ti kene e qe smund ti tregojne, kerkoj sqarim nese kjo ka te beje me KKSB-ne.

Gentiana Mazrrekaj- KKSB gjithmone perfaqsohet me nje zyrtar te policisë, kurse sa I perket asaj reklames ata thirren policet e lagjes dhe eshte vendose aty por edhe ne krejt Kosove dhe me numrin e kontaktit besoj se mund ti kontaktoni, por nuk mund te flas ne emer te tyre se nuk jam kompetente.

Vatan Istrefaj- e nderuar, besoj kjo mbledhje nuk eshte mbajte vetem per raportin e performances komunale edhe du me dite pak ma shum rreth pikes dyte te rendit te punes qfar kini diskutuar, e shoh qe eshte ne diksutim dhe planifikim e nje aktiviteti vetdisues per personat me aftesi te kufizuar ne bashkpunim me OSBE-në a mundesh ti me na spjegu pak kete teme.

Orges Tafilaj-po shfrytezoj rastin me riceke edhe nje here problematiken e shpejtsise qe po zhvillojne veturat ne rrugen qe shkon te Manstiri te cilen e kam ngrite shum here dhe nje pjese e mbrojtseve te metalta veq jane te largume te pjesa e kanalit per ata qe shetitin me fëmij eshte kogja e rrezikshme edhe e dyta meqense eshte edhe drejtori I arsimit, ne shkollen e fshatit Lebushe po e perseriti ndoshta per te pesten here pasqyra orientuese e telekomunikacionit eshte hjeke per shkak te eres se forte edhe eshte mire sa ma pare te vendoset, meqenëse është e rrezikshme si për femijët dhe për prindët që e frekuentojnë ate rrugë.

Gentiana Mazrrekaj-sa I perket aktiviteve te perfshira per personat me aftesi te kufizuara ne në plan vjetor e kemi pase si pike edhe se bashku me OSBE-në kemi mendu me mbajte ni fushate ose ni aktivitet vetdijsues per persoant me aftesi te kufizuar duke I perfshi te gjith ata persona, nuk eshte aktivitet aq I madh por vetem si shenje qe edhe ata te jene pjese e integruar e shoqerise sone, nuk eshte caktu ende data por ne momentin kur caktohet data unë mund te ju lajmeroj edhe juve dhe do te jini pjese e atij aktiviteti, kurse sa I perket qeshtjes se rrethojave ne rrugen e manastirit une do ta diskutoj edhe do ta zgjedhim at problem.

Kryesuesi- faleminderit nga ju dhe antaret tjere qe jane pjese e KKSB-se poashtu faleminderit edhe nga koleget per diskutimet qe I paten dhe ketu e mbylli debatin rreth kesaj teme.

IV.Të Nryshme.

Kryesuesi- meqense eshte seanca e fundit e kesaj perberje unë shfrytezoj rastin te ju falenderoj te gjithve per krejt kontributin qe e kini dhane per kater·vjet, sepse ju per kater vjet kini qene zani I qytetarve, I nevojave I halleve dhe I shqetsimeve te tyre, pozite e opozite, por nganjëhere edhe brenda nje subjekti nganjehere ndajme mendime te ndryshme por kjo eshte vlere e demokracisë edhe kerkoj ndjese nese ndonejhere kam mujte me pase ndonje leshim, mirepo ka qene kenaqësi edhe per mua edhe privilegj me qene edhe kryesues kuvendi edhe me punu bashkë me ju, keleget te cilet jane rizgjedhe ju uroj sukses, ata te cilet nuk do te jene ma pjese e kuvendit ju uroj suksese. Menoj se I kemi bere disa pune te mira edhe per kuvendin, ne radhe te pare me vjen mire qe kam pase mundesi mi shty perpara edhe kerkesen e juve qe me pase nje transparence ma te madhe ne kuvend edhe sot qytetaret kane mundesi me na percjelle me ato qe I diskutojme dhe kjo eshte bere per here te pare ne komunen e Deçanit, pastaj kemi mberri edhe ne aspektin e digjitalizimit, po ashtu I pergezoj te gjith koleget qe kane qene pjese e komisioneve per kontributin qe kane dhene aty, poashtu edhe ju pergezoj per rregulloren per sistematizim te vendeve te punes ku kini kontribu qe aty te jete e perfshire edhe zyra e kuvendit ne menyre qe te rritet sherbimi ma I madh sa I perket aspektit te kuvendit.

Kryesuesi e hapi debatin rreth pikes te ndryshme.

Arjan Dobraj-para se mi përshëndetë pozitën dhe opoziten dhe gjith te tjeret e pata nje pyetje per drejtorin e arsimit zotin Besnik Hulaj, meqense po e quaj veten si bashkiniciator te ndertimit te çerdhes ne fshatin Gramaçel, dashta me dite deri ku kemi mberri, a jemi gati me fillu punimet apo si qendron puna.

Drejtori, Besnik Hulaj- siq jemi te njoftuar edhe me pare ne Deçan I kemi te inicuara 5 çerdhe, çerdhja e Carrabregut per momentin eshte ne fazen e dyte, faza e pare punet e vrazhda jan krye, ne Gramaqel dhe ne Strellc jane te pranuara si projekte dhe kure fillojne nuk varet nga ne por nga Ministria, ndersa çerdhet e adaptuara ne Irzniq dhe ne Isniq, te dyja kane qene projekte te Bankes Boterore dhe sipas email-ave te fundit nga ministria ne kemi mi bo project-dizajnin per keto dy çerdhe qe kane me u adoptu nga shkolla ne çerdhe,

project-dizajnin e Irzniqit e kemi dorzu per te katerten here dhe jemi duke pergaditur project- dizajnin per Isniq.
Sylë Balaj-pyetje per drejtorin e arsimit, a eshte bere furnizimi me dru dhe pelet per ngrohje te gjitha shkollave.
Besnik Hulaj- po, te gjitha shkollat jane furnizu me dru dhe pellet ne muajin gusht, sepse e kemi si project tre vjeqar me furnizuesin, por te gjitha procedurat jane krye sa I perket druve dhe peletit për nxemje të shkollave.
Yllarta Thaqi-faleminderit shumë , nuk e kam dite qe eshte seanca e fundit ne kete perberje, megjithate nuk kam ndonje pyetje por vetem desha me I falenderu gjith votuesit e mi qe nuk me kane lene numer por kuote ne kete perberje, njekohesisht me I falenderu Ekzekutivin dhe legjislativin per bashkpunimin, ndoshta nganjehere e kemi tepru me kerkesat tona, ndonjehere ja kemi arrite qellimit me I zgjidhe ato problemet, ato kerkesat e qytetarve te cilët na u kan drejtu si asamblist, atyre qe nuk kemi arrite me zgjidhe kerkesat e tyre ju kerkojme ndjese, shpresojme qe legjislatura tjeter te jete hala ma e zeshme se ne, megjithate kam disa pengje me te cilat kerkesat I kam parashtruar por nuk kam arritur qe ti zgjidhi, mirepo pavarsiht qe po me perfundon manadati prap do te jem zeri I qytetarve ku do ti drejtohem pozites dhe opzites, por nje gje e kam peng, Mamografin per QKMF, per te cilin nuk do te ndalem ndoshta edhe ne nivelin qendror do ta kerkoj, sepse jemi ne diten e fundit te mbylljes se fushates vetdijsuese te luftes kunder kancerit të gjirit dhe kemi numer te rritur te rasteve te prekura jo vetem te gjinise femrore por edhe te gjinis mashkullore, kam edhe pengje tjera qe nuk kam arritur ti realizoj si kerkesa, por jam e lumtur qe kam arritur brenga ketyre kater viteve te perfaqsoj qytetarin I cili me ka votuar, ju uroj suksese legjislatures ne vazhdim.
Kryesuesi- une potencialisht thashe se eshte seanca e fundit, por kjo varet nga çertifikimi I rrezultatateve, nese KQZ-ja e vonon procesin e certifikimit te rezultave ne prap do te mbajme mbledhje.
Vatan Isrefaj-siq po shihet nuk eshte kryetari dhe as drejtori I sherbimeve publike per te cilet I pata disa kerkesa per lokalitetin nga I cili vie, por shfrytezoj rastin qe ato ti percjelli permes formes elektronike permes e-mailit, poashtu nese kjo eshte seanca e fundit shfrytezoj rastin ti falenderoj te gjith koleget qofte nga pozita dhe opozita, besoj se kemi qene pjese konstruktive e kuvendit komunal, me vjen mire qe kemi arrite ti kryejme disa pune ne bashkpunim, si psh. Pjesen e digjitalizimit te seancave, e keshtu me radhe, e per te gjitha punet qe na kanë mbetur ne gjysme shpresoj ti kryejme ne mandatin e adhshem.
Mon Selmanaj-une pata deshire qe tua drejtoj nje fjale timen per te gjithe ju ketu per ekzekutivin dhe per votuesit e mi qe per 8 vite radhazi me kane votuar qe te jam perfasues I PDK-se ne kuvend, une jam perpjeke me qenjen time qe ketij kuvendi komunal dhe kesaj komune ti jap ma te miren nga vetja, por shpresoj se ja kam arrite nje pjese, sepse asnjehere nuk eshte mjaft, sepse njeriu gjithmone ka kerkesa dhe angazhime, mirepo une nuk e kam kursye veten nga te gjitha keto. Jam përpjek te perfaqsoj partine qe me ka pru ketu, qytetaret qe me kan votu qe te japi kontributin tim, per te gjitha diskutimet ne keto vite te

mijat, nese ndokush indirect eshte preke nga ndonje qendrim imi Ị kerkoj falje publikisht dhe po shpresoj dhe uroj qe ata qe jane zgjedhe ne legjislaturen e re te kene nje angazhim te mirfillt te prezentojne projekte dhe ide qe vijne nga qytetaret dhe ju deshiroj shum suksese. Zoti kryesues me shprese se do te jeshe prap kryesues I kuvendit ki qene shembull I unitetit sipas meje dhe shpresoj se do te vazhdosh ashtu si dhe urime per te gjith ju qe kini fituar ne mandatin tjeter urime edhe per ne qe nuk jemi, dhe te pime dhe ta shijome kafen se bashku.

Kryesuesi- Baca Mon je I mrekullueshem, shendet na se bashku ne pune edhe ne jete se bashku.

Arjan Dobraj-kryesues faleminderit shum per fjalen ndoshta te kam lodhe shpesh tuj marre fjalen vakt e pa vakt, nganjehe ma ki nale fjalen por I ki pase edhe ti arsyet tua dhe nuk ka lidhje, kolegë dhe kolege asamblist te kuvendit komunal te Deçanit, perfaqsues I OSBE-d-se flm qe ke ardhe, Bledar flm qe je ketu me ne sot edhe te falenderoj ne emer te gjith qytetarve te Deçanit per Muralet qe je tuj ndertu per me rikthy historine edhe mos me harru ate neper te cilen kemi kalu, edhe ju perfaqsues te administrates qe jinni present ju falenderoj per bashkpunimin qe kemi pasur ne keto kater vite, ka pas raste kur kini shfaqe paknqasi ndaj nesh , pi shoh Enverin atje qe ma ban shpesh me gishta per shkak te terheqjes se vendimit per shujta te puntorve te administrates, e di qe ka qene ndoshta nje vendim I ngutshem por ka qene nje vendim duke menduar qe do te behet ma mire ma tutje, por realisht kjo nuk ndodhi, si do qe te jete kisha dashte me I falenderu edhe drejtort prej ekzekutivit, poashtu edhe zonjen Dyke –sekretaren e kuvendit sepse mu me ka ra me pasë nje bashkpunim kogja ma te gjate dhe ma te thelle pergjate ketyre kater viteve per qka e falenderoj nga zemra sepse qdo here ma ka hape deren edhe me ka mirprite edhe shpesh me ka prite sikur te ishim familjar dhe jo bashkpuntor, kolegve nga opozita dhe nga pozita I falederoj per bashkpunimin sepse me shumicen prej disa prej tyre kemi qene ne komisione, une kam qene ndoshta nje rekordmen I komisioneve ndoshta kam qene ne 17 komsione sepse mendoj se vullneti dhe deshira kane qene te medha per pune edhe uroj qe ato vendime qe I kemi marre neper komisione mos te mbesin vetem ne leter por te zbatohen ne praktike, ka qene pervoje e mire dhe jashtzakonshme, pervoje e cila mbahet mend gjith jeten, disa prej nesh qe skemi kandiduar nga te gjitha partite qe jemi ketu ose qe nuk ka fituar une mendoj se te gjithe kemi qene meritor me fitu edhe me qene pjes e ketij kuvendi, sepse mendoj se te jesh perfaqsues I popullit ne nivel local eshte detyra me fisnike e mundshme qe mund ta bej njeriu, e di qe ka profesione tjera siç eshte ai I mesimdhensit dhe I mjekut qe konsiderohen fisnik, por une mendoj qe nuk ka nder ma te madh dhe privilegj se sa te perfaqsosh direct qytetarin, ata me te cilet jeton qdo dit ketu per ti adresuar kerkesat e tyre ne kuvendin komunal, edhe nje here faleminderit prej ju te gjithve, faleminderit prej kryetarit te Komunes, Bashkim Ramosaj edhe pse nuk eshte sot, une I jam borgj atij per shkak te perkrahjes qe ma ka ba prej fillimit e deri me tash, I cili me ka shty shum perpara me motivim edhe me perkrahjen qe ma ka ba, faleminderit edhe nje here te

gjthëve, ju uroj suksese atyre qe kan fitu, ketyre qe skan hy ne gare edhe atyre qe skan fitu uroj qe te jemi bashk ne jeten e perditshme, suksese te gjithve, faleminderit.
Kryesuesi- a ka dikush tjeter diqka, ateher e falenderoj shum Arjanin qe e pershendeti edhe zotriun Bledar Qakolli I cili eshte ktu, Bledar me lejo me te pergezu per vepren e artit-Muralin, qe po e ben atje edhe me te uru suksese, faleminderit qe te patem ketu sot, nese nuk ka tjeter per fjale po e bejme nje foto se bashku edhe mir u takoshim ne takimet e radhes.

Procesmbajtëse
Dyke Llolluni

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ